

KOSOVARJA

Pse shalli
është qefini
i rugovasve

Të voglat me trup
që e kallin skenën

*Daki,
nga Mirashi,
30 vjet jetoi
në bunker*

*I veçanti
Shkumbin
Ismaili*

Si ia gjeta
ilaçin
gruas sime

Gjinnazistët
flasin për
seksin e parë

*Mjerë ai
që i ka
dy dashnore*

BIANCA,
këngëtarja luksoze e skenës

remos

a.g.e.stop

JARDIN

UNIK

CIMA

UB
UNION BUSINESS
ALBANISCH & DEUTSCH

DINO
CERAMICHE

Shkabaj

DENTFIX

SHKEND
DUBOVA

SHERWOOD

iAs

allure



DINO COMPANY



📞 Dinokontakt 📞 Dinodertel
📧 Dinokontakt 📧 Dinodertel

www.dino-company.com



E duam shtetin, por secili duam të jemi në krye të shtetit!

Fjala është për shtetin tonë: e vjedhim, por e duam. E gjykojmë, por e duam. E fusim në ujë, por e nxjerrim, sepse nuk di të notojë sa duhet. Nuk ka si ne që e duam shtetin! Por, keq, duam secili të jetë në krye të shtetit!

Një familje me traditë intelektuale jetonte në Kosovë. I zoti i shtëpisë i kishte katër djem. Takohet me një shok të kohës, pas tridhjetë vitesh, dhe fillojnë muhabetin e pangopshëm. Ai e pyet shokun:

- Sa djem i ke?

- Katër.

- A kanë mbërri hiç, a ende janë të ri?

- I madhi është inxhinier, i dyti profesor, i treti asistent në fakultet.

- Paj, dihet se ju gjithmonë intelektualë keni qenë dhe ende po e mbani atë traditë...

- E, i katërti ku është? – e pyet ai.

- I katërti mos vetë, është bërë hajni!

- Auuu, ua paska prishur strukturën! Pse nuk po e nxirrni nga shtëpia?! – i thotë miku.

- Si me e humbë djaln, ore?! Mu ai po e mbanë shtëpinë! Po të mos ishte ai, shtëpia ime mbaron për 24 orë, sepse secili djalë tjetër ka rrogë të vogël dhe nuk ia dalin në krye as për nevojat e veta e lëre më për shtëpinë tonë...

Dhe, duke ditur se shteti është një lloj familje, po mendoj shteti i Kosovës, lehtë mund të krahasohet me këtë familje, e që e mbanë shtëpinë djali më i vogël, hajni! Ai që vjedh i ka të gjitha. Tamam

si ajo familja e katër djemve që e zëmë në gojë më lart. Për tre djemtë tjerë nuk e bartë gjale i zoti i shtëpisë nëse janë martuar apo jo, nëse duhet t'u gjendet nusja e mirë apo jo, por për hajnin patjetër, sepse ai e mban shtëpinë. Pra, hajni i ka në dorë të gjitha. Ta zbërthesh në shqip, i bie se ai e ka mandatin e qeverisjes familjare, në të cilën e ka respektin dhe nuk mund t'i përzihet askush në shtëpi. Ai, pra, është sovrani qeveritar i shtëpisë, ai i merr vendimet dhe i kryen obligimet e shtëpisë.

S. Murturi



Bianca, këngëtarja luksoze e skenës

Bianca Junzell është këngëtare unike e skenës muzikore, e që duket si divat botërore, por është shqiptare. Është rritur në Suedi. Jeton në luks, por asnjëherë nuk harron kush është dhe nga vjen. E bukur, artiste me kuptim të plot të fjalës dhe me shumë hite, Bianca është rikthyer në skenë edhe më e fuqishme se kurrë më parë. Ç'thotë në "Kosovare"?

Bianca, jeni në muzikë që moti. Por, për ata që rastësisht nuk u njohin, a mund të na flisni pak më shumë për veten?

- Prindërit e mi janë nga Peja. Jam e rritur në Suedi, ku edhe jetoj e punoj. Këtu jam rritur e martuar, por Kosovën dhe popullin tim e dua shumë dhe ndihem 100% shqiptare.

Këndoj qëkur isha e vogël. Në moshën 14-vjeçare kam nisur të këndoj nëpër vende të ndryshme në Evropë, me grupin tim. Pastaj, bëra një pauzë në muzikë, krijova familje, u shkollova etj. Ama, çdo herë brenda meja mungonte muzika, andaj në vitin 2019 u riktheva me këngën "Për veti të kam".

Kush të tha se je për muzikë?

- Qysh në vegjëli i kam imituar këngëtarët e njohura: Lepa Brenën, Roxette, Tina Turnerin. Dhe, të gjithë

në familje e kanë ditur që unë do të bëhem këngëtare.

Të kujtohet kënga e parë dhe emocionet që përjetove në skenë?

- Pa dyshim, po. Ishte kënga "Xhamadani vija-vija". E këndova në një koncert "live", në vitin 1990, në Stokholm. Kam pasur emocione të forta, por performanca rrodhi shumë mirë.

Kur u mëshirove me muzikë?

- Përherë kam qenë shumë e lidhur me këngën. Kur isha në pauzë, e ndjeja mungesën e saj. Në vitin 2019, pas disa vitesh mungesë në skenë, realizova këngën e parë dhe deri sot i kam prezantuar rreth 20 këngë në gjuhën shqipe, së bashku me këngët e vjetra.

Kënga me të cilën ke goditur?

- Kënga "Oj zemër" dhe "Dil te kroni Cuco". Këto dy këngë publiku i pëlqeu shumë.



Projekti yt me titull "Oj zemër" është modern. Si të lindi ideja?

- Është një këngë e veçantë, që u këndohet atyre që dashurohen në distancë. Është këngë e harmonizuar, verore, moderne dhe shumë e hareshme.

Pse një duet me Kastro Zizon dhe a je e kënaqur me bashkëpunimin?

- Kastro është unik në muzikë e stil, sepse i shprehë 100 për qind ndjenjat kur këndon. Jam shumë e kënaqur me projektin dhe kam kujtime të mira nga bashkëpunimi.

Me kë tjetër do të realizojë një duet?

- Nuk mendoj të realizoj sërish duet, pasi ky me Kastron më mjaftoi. Më pëlqen kur jam vetë në skenë, ashtu si Adele apo Uitni Hjuston, të cilat japin njëqind për qind nga vetja.

Ke ndonjë emër me të cilin nuk do të bashkëpunoje asnjëherë?

- Jo, nuk dua ta ofendojë askënd.

A po vjen me diçka të re?

- Po, pas pak ditësh do të paraqitem me këngën time të re.

Cila është jeta jote private?

- Bëj jetë të qetë. Jam e martuar, nënë e tre fëmijëve. E kam edhe një qen chiuaua, e që më shoqëron edhe kur jam në punë me klientët.

Në kohën e lirë jam me familje. Këndoj në studio, shkoj në gym.

Vikendeve shkojmë në bjeshkë, sepse e dua natyrën dhe ajrin e mrekullueshëm që kanë malet.

Gjithashtu, me burrë udhëtojmë në vende të ndryshme të botës.

Një cilësi jotja?

- Jam shumë humane dhe i dua njerëzit.

Visheni bukur, sh-trenjtë dhe jetoni në luks. A ka diçka që u mungon?

- Jo, nuk më mungon asgjë. Jam e lumtur dhe e kënaqur me jetën time.

Çka do t'u thoshit këngëtareve të reja?

- U them që duken shumë më të bukura kur këndojnë me ndjenja. Mos ta ekspozojnë vetëm trupin, sepse shumë videoklipe po duken erotike. Për mua këngëtare të vërteta janë Adele, Leona Levis apo Laura Pausini, pasi në skenë nxjerrin zërin, e jo vetëm linjat trupore.

Planet për sivjet?

- T'i realizoj planet në muzikë, të lansoj këngët e mia në gjuhën shqipe e angleze, të cilat jam duke i përgatitur.

Porosia juaj?

- Porosia ime për të gjithë shqiptarët është që pas pandemisë të mendojnë më tepër pozitivisht dhe ta motivojnë veten me fjalët: Jam komplet dhe mirë (me kokë e trup) Jam perfekt Jam i fortë Jam i shëndosh Jam i dashur Jam i harmonizuar Jam i lumtur.

Nderim Neziri



Daki, nga Mirashi, 30 vjet jetoi në bunker!

Daki jetonte në bunker... Ishte temë mbi tema në odat e fshatit tim, në kohën e rinisë sime. Bunkerin e kishte shumë të gjatë dhe në thellësi të tij e kalonte jetën me lla mbë karbiti të minatorëve...

Daki kërkohet nga hyqmeti i Jugosllavisë që ta burgosnin, sepse në atë kohë i kishte rrahur disa policë. Por, në shtëpi nuk e gjenin dot...

Ai gjeti një formë të jashtëzakonshme jete në bunker, thellë në mal.

Personazhi i ngjarjes, Daki, tërë jetën më mbeti në kokë si njeri që jetonte mes reales dhe iluzionit. Me dhjetëra vite më ishte bërë obsesion, nëse kishte ekzistuar realisht, apo jo...

Në vitin 2005 vendosa t'i shkoja në shtëpi. Ta shihja nga afër burrin që ishte mit i një kohe...

JETA NË KULLËN E FERRIT...

Rrëzë malit ndodhej një kullë dykatëshe prej guri. Dy dritare të vogla kah rruga, enkas për ta vënë manzerrën në nishan.

Prisja ta takoja Dakin, Bajrush Gavazin e Mirashit të Ferizajt. Në moshë të shtyrë doli nga "kulla" kur e thirra në emër. Burri i parruar, me plis, jetonte me të birin e vetëm.

Axha Dak nis rrëfimin vetë, pa i bërë pyetje fare...

"A e sheh këtë oborr dhe këtë kullë?! Sa e sa herë është rrethuar me polici. Kërkonin t'më burgosnin, sepse i kisha rrahur disa policë, derisa udhëtoja me tren për në Shkup. Nuk e nisa luftën për vete, por për një fukara, që nuk kishte para ta paguante biletën në tren. Ai tha se nuk kishte para ta paguante biletën dhe asgjë më shumë. Kondukteri i thirri policët që ndodheshin në tren. Ata menjëherë filluan ta rrihnin. Unë ndërhyra dhe fillova "luftën" me ta...

Në tollovi e sipër, treni u ndal. Kërceva shpejt nga treni dhe ika. Policët më ndoqën, por nuk arritën t'më zinin... Ata më kishin identifikuar dhe një ditë ia kishin mësy shtëpisë sime. Por, edhe pse e kishin rrethuar shtëpinë, arrita nga prapa, nga një derë e ngushtë, të kaloja në mal.

Por, i frikësuar se do ktheheshin sërish, vendosa ta bëj një bunker në vendin e quajtur "Përpjetëza", në të cilin do të fshihesha po qe se ata do më kërkonin sërish...

Dhe, për ta bërë bunkerin "të banueshëm" kam punuar dy vjet. Kur dola në pjesën e rrafshit prapa, e maskova mirë me drunj e degë. Kështu, po t'më

hetonin, arrija të dilja në pjesën tjetër të kodrës...

Ndërkohë pushteti më ka kërkuar shumë herë. Por, unë shpejt kaloja në bunkerin tim. Isha i përgatitur që, po qe nevoja, edhe të luftoja me manzërkën time".

SI I SHPËTOI AKSIONIT TË MADH TË POLICISË?

"Një ditë, një fillimdimri, kishin organizuar një aksion të madh për t'më kapur. Arrita të depërtoja në tunelin tim. E mbylla mirë hyrjen dhe eca deri në dalje të tij. E kuptova se dikush më kishte spiunuar... Në dalje të bunkerit pash se drejt meje vinin policët. E maskova daljen nga bunkeri mirë. Unë ika në mal. Ata, pasi u sollën një kohë rreth bunkerit dhe nuk arritën të zbulonin gjë, u kthyen prapa. Atë natë fjeta në mal. Kështu kam jetuar 30 vjet, derisa erdhi liria".

PSE M'U KUJTUA KJO NGJARJE?

Kjo ngjarje m'u soll në kokë teksa e kaloja rrugën pranë "kullës" së tij, të enjten, më 14 janar. Tash pranë "kullës" së tij rruga është asfaltuar, kurse shtyllat elektrike natën bëjnë dritë... Daki ka vdekur në vitin 2007.

Safet Krivaça

Pronar dhe botues:
Gani DILI

Redaktor përgjegjës:
Isa ILAZI

Menaxher:
Driton DILI

Redaksia:
Safet Krivaça (reporter i lirë)
Nderim Neziri (redaktor)
Besiana Dili
Drenushë Haredinaj
Rilinda Krasniqi
Dionita Sadrija
Arta Dreshaj

Dizajni:
Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:
Fahu postal 18, 10000 Prishtinë
Tel: 038 51 75 75
Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:
Tel: +383 44 143 448;
Email: marketing@kosovarja-ks.com



DAKIKU I POPULLIT

20 VJET PAS LUFTE. ÇKA?

Çuditërisht, gjatë këtyre viteve, kryesisht, pjesa dërmuese e popullit ka heshtur, ka pritur - realizimin e ëndrrave të shumta, ditë të mira në liri, në mes njëri - tjetrit më shumë dashuri, solidaritet, por edhe pak jetë, që, s'pakut, të mos i shkojë mendja dikujt të ikë nga Kosova...

Çuditërisht, them prapë, populli im ka lejuar që shtetin e ardhshëm ta definojnë ekstremistët dhe profiterët politikë! Ka lejuar që në kokë t'na hipin politikanë analfabetë, ministra diletantë, e që pushtetin e kanë shfrytëzuar për të rritur pasuritë e tyre dhe për të punësuar farefisën e pashkollë! Ka lejuar që themelet e pavarësisë së shumëkërkuar të na i ndotin tenderët, korrupsioni, trafikimi, kontrabanda! Ka heshtur populli! Ka duruar Kosova! Tash? Mbase, momenti që populli të mos heshtë më!

PO ZBULOHEK VETJA!

Jo qëllimisht shfletoj librin e shkrimtarit hungarez Imre Kertez dhe ndalem në faqen që, pastaj, jo rastësisht i shënoj këto fjali:

"A keni vërejtur se në këtë shekull gjithçka po bëhet më e vërtetë, se po zbulohet vetja e së vërtetës?

Ushtari bëhet vrasës profesionist, politikani kriminel, kapitali bëhet ndërmarrje për eliminimin e njerëzve, ligji bëhet rregull për pazare, liria botërore bëhet burg popujsh".

KUSH ISHE DJE, KUSH JE SOT?

Sa ka ndryshuar njeriu ynë?! Është ky mendim që shpeshherë e hasim në biseda, në ndeja. Vërtet, nuk di cila është e vërteta për njeriun tonë: A ka ndryshuar dhe sa ka ndryshuar sot? Apo, ishte ky i sotmi edhe dje, por që e djeshmja tragjike e kishte kolektivizuar, që të ndihej më pak i frikësuar në veprimin e përbashkët kombëtar? E, të gjitha këto sot duken relative... Vërtet, cili është njeriu ynë sot?

E POPULLIT

Ish kan njani, të cilin e kishin pas zgjedh kryetar komune. Ai, ni ditë, derisa ishte në zyrë, nga xhepi nxori pasqyrën dhe nisi ta shikojë veten.

E sillte kryet sa dhathtas e sa majtas dhe ia bante vetes: "Eu Rahman, eu! Edhe botha jote u ba kryetar!"

Gani DILI



Pse shalli është qefini i rugovasëve?

Rugova, vend i lashtë historik, njihet në literaturë që nga viti 1292. Për Rugovën ka shumë legjenda, por një është e vërtetë: shalli rugovas, i quajtur “marama e burrave të Rugovës”, është qefini i tyre.

Shallet e gjata rugovase, të ash-tuquajtura “mahrama tradicionale”, janë qefini i tyre. Në fshatin Kuçishtë tregojnë këtë historik dhe thonë se burrat e Rugovës gjatë historisë së tyre të pasur, gjithmonë u janë nënshtruar luftërave me sllavët, prandaj i kanë bartur mahramat e gjata me dhjetëra metra për t’i mbuluar meshkujt që vriteshin në luftëra të ndryshme.

Pra, ky është simboli më original dhe më karakteristik i këtij vilajeti, së bashku me mitanët.

LOJËRAT TRADICIONALE DHE KËNGËT E ÇIKAVE

Rugova është i vetmi rajon në Kosovë ku zhvillohen me ëndje lojërat popullore gjatë stinës së verës.

“Loja Gurapesh” është disiplinë sportive, ku garojnë burrat e fuqishëm në hedhjen e gurit.

“Loja e ngasjes së kuajve” është një disiplinë e vjetër sportive, e cila ka traditë qindvjeçare në Rugovë.

“Tërheqja e litarit” është një lojë tjetër interesante në Rugovë. Kjo lojë mund të realizohet individualisht, por edhe në ekip.

“Kënga e çikave” dallohet në masë

të madhe nga këngët e rajoneve të tjera të Kosovës. Me këtë rast po japim një strofë të një kënge të çikave, e që këndohet në Kuçishtë: Kujaj moj çikë

Në qosh të shpisë

Ty po t’pret veni i çinisë.

Janë interesante, sidomos, këngët e kanagjeqeve, e që janë të pasura me mallëngjime dhe nostalgji.

Por, me largimin e një pjese të madhe të popullatës nga Rugova për në Pejë e gjetiu, këngët e çikave sa vijnë e harrohen, meqë rrallë edhe këndohen, pasi që në Rugovë më nuk ka jetë të përherëshme, me pak raste që i hasim aty-këtu në Haxhaj e gjetiu.

Njerëz me bollëk në Rugovë hasim vetëm gjatë verës, të cilët shkojnë atje për t’i shijuar bukuritë natyrore të këtij vendi të rrallë natyror.

S.

Sa herë vjen miku im nga Suedia po ma prish rahatinë në familje!

Disa mërgimtarë edhe sivjet u panë me xhipa të teknologjisë së fundit. E, kush nuk ua ka lakminë, sidomos në këtë kohë krize në Kosovë, në këtë kohë pandemie?! Por, njëri prej tyre, më tha troç: Nuk është i imi, e kam marrë me qira. Bile, nuk kam para mjaft as për benzinë me u kthye në Suedi...”.

Një i afërm imi edhe sivjet erdhi me xhip nga Suedia. Xhipi i ri veç xixël-lonte. Gruaja, natyrisht, paksa xheloze, u tha djemve të shohin pak më larg se çka është jeta në Perëndim... Dhe, filloi t'më qortonte edhe mua... “Të kam thënë të ikim, të dalim edhe ne diku, në Perëndim, e të jetojmë

qysh jeton bota! Por, ti nuk më dëgjove kurrë! E do këtë drejtim që është i mirë veç për politikanët tanë dhe askënd tjetër. Tash fëmija po i lakmojnë kur po i shohin kurbetçarët me almet vetura të shtrenjta, me veshje të shtrenjta, me respektin që po ua bëjnë...”

XHIPAT QË VEZULLOJNË I MARRIN ME QIRA!

I afërmi im, e që erdhi pak ditë para Vitit të Ri, erdhi me një xhip që veç vizëllonte. E hapi dritaren e tavanit të xhipit dhe ua tregonte djemve të mi karakteristikat e “shiberit”.

“Ky nuk është xham i thjeshtë, por xham special!”, lavdërohej ai.

Në vete them: Oh, bre, po ç'më more në qafë! Sa herë po vjen, po ma prish rahatinë në shtëpi!”

Në mbrëmje i vumë në sofër gjithë të mirat që i kishim në shtëpi: pulë, tavë me oriz, pite...

Pas dy ditësh gruaja e mikut erdhi te ne përsëri me xhip.

“Mirë se vjen! Mirë se të solli Zoti! Ku është ai?”, i themi ne.

“Nuk erdhi, sepse doli me një shok në kafe!”, thotë ajo.

Dhe, teksa pimë kafe, ia nis politikës. Ku hyn e ku del... Veç mendtë që nuk na luajtën...

E, para se të ngrihej, si me keqardhje, na thotë:

“A keni me nja dhënë 1000 euro se nuk kemi mjaft para për rrugë, e posa të arrijmë ua përcjellim me postë të shpejtë?”

“Pasi keni mbetur pa para, mikeshë, a po na e shitni xhipin, pra?!”.

“Jo, nuk mund t'ua shesim, sepse xhipi nuk është i yni. E kemi marrë me qira”.

“A nuk është xhipi juaj, a?!”.

“Jo, jo. Nuk kemi para për xhip! E morëm me qira që të kujtojnë të afërmit tanë se kemi veturë të mirë...”

“Mikeshë, ne menduam se xhipi është i juaji... E ju, po ardhshi me vetura të shtrenjta sa për t'ua shti lakminë të rinjve tanë se atje ku jetoni jetohet mirë, a?!”.

Ajo ulë kokën dhe nuk flet më. Ngrihet shpejt dhe nisat drejt e kah dera, pa thënë më asnjë fjalë...

Kur ajo shkoi, i them gruas: “Më thuaj, tash, ku qenka më mirë të jetosh - në Kosovë a në Perëndim?”

S. K.

"S'kish ma keq se plakut me i vdekë gruaja!"

Me autobusin numër 4 të Prishtinës, pensionistë të shumtë ia mësyjnë Gërmisë, që në orët e para të mëngjesit dhe kthehen diku rreth orës 9 për në Prishtinë.

Në autobus, deshe a s'deshe, dëgjon gjithçka nga pensionistët. Këtë herë ja se çka shënova në notesin tim...

Autobusi numër 4, e që qarkullon nga Mati nëpër qytet e deri në pishinën e Gërmisë, në orët e para të mëngjesit është i mbushur, kryesisht, me pensionistë të shumtë, të cilët që në orët e hershme të mëngjesit, verë e dimër, ia mësyjnë Gërmisë.

Pjesa më e madhe e pensionistëve njihen ndërmjet veti. E, kur ka të tillë që nuk i njohin, biseda e parë bëhet: "Prej nga je?", për të kaluar më pas në ndonjë llaf që "atij i dhemb".

POLITIKËS NUK I SHPËTON NJERIU AS NË AUTOBUS!

"A je, ku je?", përshëndeten dy vetë, sapo ulen pranë njëri-tjetrit.

"Juve të institucioneve nuk po ua ndien

për neve, pensionistëve, bash hiq!", i thotë i pari të dytit, e që ky i fundit, nga pamja, nuk dukej se ishte pensionist, por që, me siguri, ende punonte.

"Çka me ba me 90 euro pension?! Kah me i qu përpara! Veç për ilaçe më shkojnë 50 euro në muaj!", i thotë plakut, paksa me ton të lartë, me qëllim që ta dëgjojnë edhe të tjerët përreth.

"Çka të duhen paratë ty, bre?!", ia kthen njëri që, si dukej, e njihte mirë.

"Qysh çka më duhen?! Në Gërmë nuk po na japin kafe pa pare! Ja çka më duhen, pra!", ia kthen ai si me mahi.

"Hajt bre, ti je myt tu mbajt konferenca në socializëm e ende paske dëshirë me fol!", ia kthen po i njëjti, me qeshje.

"Jo, jo. S'ka ma keq për ne, pleqtë. Po na plasë zemra si po na trajtojnë politikanët tanë, të cilët në kohën kur unë kam punu, ata as që kanë qenë në këtë dynja! E, tash janë ba të paprekshëm – me xhipa e villa, e ne, fukaraja, nuk kemi ni kafe me e pi në

Gërmë!", ia kthen me mllef.

"Hajt bre, lëri ti politikanët!", ia kthen ai, më shumë si ngacmim.

"Hë, bre, si me i lanë?! A po e sheh se do mbesim edhe pa ato 90 euro?! S'ka qeveri! S'ka buxhet! Sepse, ambiciet për pushtet ua kanë marrë edhe mendtë! Secili do me qenë kryeministër! Di a s'di kush s'të vetë!", shpërthen ai, i moshuari.

"Lëri politikanët, po a e ke ende plakën gjallë, obo?", mundohet t'i jep kah tjetër bisedës ai, e që dukej se ende punonte.

"Jo, që dy vjet po bahen e unë jam pa plakë", ia kthen ai, me gjysmë zëri, dhe vazhdon: "Në pleqëri s'kish ma keq se me të vdekë grua. Fëmija janë shpërnda...". Dhe, me këtë muhabet edhe përfundon biseda ndërmjet këtyre vetëve, meqë të dy zbresin në stacionin te Pallati i Rinisë. E, po në atë stacion hyjnë disa të rinj e të reja dhe biseda ndërmjet tyre tashmë merr kah tjetër...

I. I.





Gur mbi Gur...



Blej Banesën tënde me super ofertë

pa kamatë, pa garantues, 60 muaj
direkt në Cima Construction

049 656 666 | www.cimaks.com | cima.shpk@gmail.com

fc Ballkani



Since 1947



fb.com/Ballkani1947



www.fcballkani.com

RESTAURANT

LORIANO

LOUNGE & BAR



Loriano, një tregim i ri



040 561 526 | kemal.raci@gmail.com | LORIANO Restaurant

Xhevdet Ajeti - i veçanti jo vetëm i "Bayern Munchenit"

Shqiptarët, kudo që kanë shkuar, nëpër Evropë a botë, nuk kanë pranuar të jenë, thjesht, punëtorë krahu, apo argat të diku-jt, por gjithmonë kanë provuar ta tregojnë veten në secilën lëmi që u është dhënë mundësia...

Se shqiptarët kudo në botë janë treguar të aftë e të shkathtë, tregon edhe historia e Xhevdet Ajetit, i cili jeton e vepron në Gjermani, ku merret me ndërtim, e që sot, me punë e ndershmëri, i mbanë më shumë se 300 punëtorë, të cilët janë të kënaqur me Xhevdetin, shefin e tyre.

Xhevdeti njihet si "fenomen" në Gjermani, pasi që pasioni i tij për punën dhe menaxhimin ka arritur të triumfojë, jo vetëm në arritjen e të mirave materiale, por edhe të bëhet simbol i të bukurës, i estetikës.

E, për këtë mjafton të shohim te Stadiumi i "Bayern Munchenit" apo i Dortmundit, te këto dy mrekulli të futbollit, e ku ka qenë pikërisht "dora" e Xhevdetit që ka lënë gjurmë, me të cilën mund të krenohen të gjithë shqiptarët anë e kënd globit.



XHEVDETI - KUDO I PARI...

Absolutisht, nuk mund ta harrojmë as pjesën e humanizmit, karakteristike e shqiptarit, që gjithmonë ka ndarë për të tjerët nga vetja. Xhevdeti është sponsor gjeneral i klubit futbollistik shqiptar në qytetin e tij dhe asnjëherë nuk ka hezituuar të jetë i pari kontribuues në xhamia e shkolla për komunitetin shqiptar, sa herë që i është kërkuar, por edhe për bamirësi të tjera, për të cilat Xhevdeti as nuk dëshiron të flasë.

ÇKA MUND TË PËRFUNDOJMË?

Xhevdet Ajeti, pa dyshim, është shembull i një shqiptari të mirë e punëtor, pasqyrë e mirë e diasporës sonë në Gjermani, shembull të cilin duhet ta ndjekë çdo shqiptar kudo në Perëndim. Sidoqoftë, jo të gjithë mund të kenë fatin të jenë të suksesshëm si Xhevdeti, por, të paktën, të përpiqen e të na e zbardhin fytyrën kudo që janë ata...



SPIELSTADT

2021

JANUARY

S	M	T	W	T	F	S
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30
31						

JULY

S	M	T	W	T	F	S
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31

FEBRUARY

S	M	T	W	T	F	S
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28					

AUGUST

S	M	T	W	T	F	S
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

MARCH

S	M	T	W	T	F	S
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31		

SEPTEMBER

S	M	T	W	T	F	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30		

APRIL

S	M	T	W	T	F	S
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	

OCTOBER

S	M	T	W	T	F	S
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30
31						

MAY

S	M	T	W	T	F	S
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					

NOVEMBER

S	M	T	W	T	F	S
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30				

JUNE

S	M	T	W	T	F	S
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30			

DECEMBER

S	M	T	W	T	F	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30	31	

Xhevdet Ajëti

Cilat janë të voglat me trup që e kallin skenën?

Nuk janë më të gjata se 160 cm, por në asnjë moment nuk u mungon pamja dhe stili që shfaqin. Përveç kësaj, këto femra shqiptare armë të fortë kanë zërin dhe prezantimin para publikut. Lirisht mund të themi se janë diamante, të cilat sapo të dalin në skenë ndriçojnë, rrezatojnë dhe përvetësojnë publikun. Cilat janë ato?



AURELA GAÇE - MBRETËRESHË E KËNGËS

Aurela Gaçe ka një jetë që i tregon botës se sa "crazy" është. Ndoshta fakti se është e shkurtër e bën të kërcejë fuqishëm në skenë. Megjithatë, me talentin dhe përvojën në muzikë që ka, sa herë që është prezantuar para publikut, ka bindur se është një mbretëreshë e skenës.



FLAKA KRELANI - GJITHMONË ME STIL

Flaka Krelani është, gjithashtu, jo e gjatë, por zëri dhe stili i saj çdo herë pushton skenën. Flaka vazhdon të mbetet njëra nga këngëtarët me zërin më të mirë në estradën shqiptare.



MIRSA KËRÇELI - MAHNITË ZËRI I SAJ

Mirsa Kërçeli, së pari, u shfaq në spektaklin "Ethet e së premtës". Vajza trupshkurtër sapo doli para jurisë mahniti me zërin e saj. Megjithatë, për publikun shqiptar u bë e njohur me këngën "Djaloshi im", në një nga edicionet e festivalit "Kënga Magjike". Interpretimi i saj ishte aq mbresëlënës sa dhe sot e kësaj dite kënga e saj mbetet më e preferuara për publikun nga repertori i këngëtares gjilanasë. Kohëve të fundit, për shkak të obligimeve familjare, Mirsa është tërhequr nga skena muzikore.



ARBANA OSMANI - MJALTË PREJ GOJE NXJERRË!

Të jesh pjesë e një televizioni nuk do të thotë se, patjetër, duhet të jesh truphollë, e gjatë... Mjafton të jesh e shkathët, inteligjente dhe karizmatike. E tillë është prezantuesja e njohur e Televizionit "Top Channel", Arbana Osmani. Nuk është e gjatë me trup, por kur del në ekran "mjaltë prej goje" nxjerrë.



KIDA - KONKURRENTE NDAJ KËNGËTAREVE ME PËRVOJË

Kida, këngëtare e re, u bëri konkurrencë mjaft të madhe kolegëve të saj që janë me vite në skenë. E bukur, me stil të veçantë. Por, pamja e shkurtër e saj nuk pengon që të ketë sukses. Talenti i saj për muzikë ka bërë që të jetë njëra nga këngëtarët më të kërkuara.



Ç'dini për seksin e parë?

Shumë nga maturantët e gjimnazeve të Prishtinës ngurrojnë të flasin se kur duhet filluar me seksin e parë, si duhet të mbrohen nga shtatzënia, apo ç'dinë për sëmundjet seksuale dhe kontracepsionin. Megjithatë, ja çka deklaruan disa prej tyre...

Në ç'moshë është koha për seksin e parë?

Z: - Nuk kanë rëndësi shumë vjetët sa është i rëndësishëm fakti se a jemi të gatshëm për një gjë të tillë...

Por, nuk është njësoj sikur je 16 a 18-19 vjet?

Z: - Po, vërtet, duhet të jesh e pjekur edhe në aspektin e vjetëve. E kjo, mendoj, është mosha mbi 18 vjet e fiu.

A ke ti përvojë seksuale?

Z: - Jo.

A mund të ndodhë t'u bindë dashnori të bëni seks, edhe pse mendoni se nuk është koha?

Sh: - Jo, një gjë e tillë nuk do të ndodhë kurrë!

A ke pasur punë me gjinekologun deri më tash?

Sh: - Fatmirësisht jo, deri më tash nuk kam pasur punë me gjinekolog. Jam e kujdesshme në raportet intime me të dashurin tim, me të cilin jam në lidhje qe një vit.

A di gjë për sëmundjet seksuale?

Sh: - Po, kam lexuar se ato mund të transmetohen me marrëdhënie seksuale të pambrojtur.

A të ka rënë të dëgjosh për ndonjë shoqe se ka probleme me sëmundjet seksuale?

Sh: - Jo, për fat të mirë...

Meqë jeni maturante, a mendoni që së shpejti të krijoni familje?

R: - Jo, së pari do të studioj, pastaj, mundësisht, të punësohem. Dhe, tek atëherë mendoj të martohem.

Nga i merrni më së shumti informatat për seksin?

R: - Më së shumti nga shoqet. Jemi të lira dhe bisedojmë për gjithçka...

D. H.

BOOM

Avni Hadërgjonaj:
Publiku nuk ka nevojë
për këngë “veç hajt”

Vesa Luma
kthehet në fëmijëri

Kush e bënë të lumtur
Dafina Zeqirin?

“5 plus 5” me
Shkumbin Ismailin

Mhrije Braha

Merilin Monro

shqiptare



Avni Hadërgjonaj ka një listë të tërë këngësh shumë të mira dhe në çdo projekt ka ardhur i veçantë, avangard dhe krejt ndryshe. E, ku është tretur këngëtari i shijes së mirë?

O Avni Hadërgjonaj, ku je tretur?

- E vërtetë, disi jam “tretur”, por vetëm në jetën artistike, ku dikur kam qenë shumë më i pranishëm. Por, vajtje-ardhjet e mija në muzikë nuk janë diçka e re. Kanë ndodhur edhe më parë. Dhe, pas çdo

Avni Hadërgjonaj: **Publiku** **nuk ka nevojë** **për këngë “veç hajt”**

largimi kthehem me më shumë energji dhe dashuri për muzikën dhe artin, në përgjithësi.

Nga ai djalë gjithë freski në botën e artit, u bëre “i humbur”. Pse?

- Në çdo projekt jam përpjekur të prezantoj diçka

të bukur, interesante e kreative. Por, disa zhvillime në jetën personale më mbajtën më larg aktiviteteve muzikore.

Sa kohë u bënë që nuk ke sjell asgjë të re në muzikë?

- Ka disa vite. Kjo nuk do të thotë që gjatë kësaj kohe

nuk kam menduar për rikthim dhe gjëra të bukura.

Ndërkohë, sa këngë i ke në sirtar?

- Janë disa këngë, balada, por edhe këngë ritmike, të cilave, pa dyshim, do t'u vijë koha.

Duket se je shumë seleksionues: ose vjen mirë ose hiç?

- Kështu edhe duhet të jetë me të gjithë. Nëse nuk ke diçka të mirë, më mirë heshtë. Publiku nuk ka nevojë për gjëra "veç hajt".

Megjithatë, cili është krijimi yt muzikor më i vlefshmi?

- Të gjitha këngët që i kam lansuar janë shumë të veçanta dhe kanë vlerë unike për mua. Por, krijimi im më i çmuar pritet të vijë së shpejti. Do të jetë këngë - dedikim për personin e zemrës, nënën time, e cila pak muaj më parë iku dhe na la përgjithmonë, duke krijuar shumë zbrazëti, mall e dhembje.



Po, kënga më komerciale që ke kënduar?

- Në përgjithësi, kam dashur që këngët e mia ta kenë një dozë arti brenda vetes. Pak më komerciale mund të cilësohet kënga me titull "Nuk të njoh". Është këngë e kohës.

Diçka që ti e çmon posaçërisht te karakteri yt?

- Reagoj me qetësi, jam korrekt e jo euforik.

Diçka që do ta ndryshojte te vetja?

- Secili kemi diçka që do ta kishim ndryshuar te vetja. Ndoshta e kisha ulur pak ndjeshmërinë ndaj gjërave të ndryshme që na ndodhin në jetë.

Ngjarja që ka lënë më shumë gjurmë në jetën tënde?

- Të bërit prind. Kjo është një ngjarje që tejkalon të gjitha të tjerat.

Pak fjalë për gruan dhe pak për vajzat?

- Jam me fat që e kam. E, vajzat e plotësojnë më së miri portretin tonë familjar.

Kur do të ndodhë rikthimi yt?

- Së shpejti.

Thuaje një gjë që e ke në mend në këtë moment?

- Faleminderit për bisedë!

Nderim Neziri





Vesa Luma kthehet në fëmijëri

Thuhet se vitet e fëmijërisë janë më të ëmblat, më të bukurat. Të tilla ishin edhe për këngëtares e njohur kosovare, Vesa Luma. Vesa kthehet në fëmijëri dhe ndan ca copëza kujtimesh nga ajo kohë.

“Fëmijëria ime ka qenë shumë e mirë dhe jam shumë e lumtur për këtë fakt. Jam rritur me lojëra jashtë shtëpisë, pa Ipad dhe me shumë komunikim me fëmijë të tjerë, gjë që sot mungon te fëmijët tanë.

Do i veçoja udhëtimet me familje, me makinë për pushime, e që rrugës këndonim të gjithë bashkë.

Ishte një ndjenjë që nuk e harroj asnjëherë”.



Kush e bënë të lumtur Dafina Zeqirin?

“Zili-Zili” mbetët projekti më intrigues i momentit, prezantuar nga këngëtarja sensacionale, Dafina Zeqiri. Kjo këngë është krejt e veçantë dhe thuhet se është “diss” për ish-shoqen e saj, Tayna.

Këngëtarja që nuk ndalet së “prodhuari” hite, pas duetit me Yll Limanin, thotë se vjen me diçka tjetër, ndërkohë që edhe jeta e saj private po shkon perfekt.

Këngëtarja thotë se e bëjnë të lumtur njerëzit që ka përreth, e që për të janë më të mirët.

Po nervoz?

Sipas saj, ata që e nervozojnë janë shumë pak.



"5 plus 5" me Shkumbin Ismailin

AsNas
Photography

I veçanti

Ai është yll i rok-muzikës shqipe, shumë origjinal dhe një nga zërat që publiku e do shumë. Më shumë i pëlqen të këndojë sesa të flasë. Dhe, lexoni "5 plus 5" me Shkumbin Ismailin.

Diçka që ta kujton fëmijërinë, një ngjarje që ka lënë gjurmë?

- Në moshën 7 vjeç, në një party, kam imituar këngëtarin Majkëll Xheksonin. Kam marrë shumë duartrokitje nga të pranishmit...

Kënga që e këndon më me dëshirë?

- Autor i të gjitha këngëve të mija jam unë dhe të gjitha i këndoj me ëndje.

Keni refuzuar, ndonjëherë, ndonjë këngë?

- Po, kam refuzuar tekstet që nuk

më përshtaten mua dhe muzikës që bëj unë.

Një duet me...

- Planifikoj për një duet tjetër me Ponin dhe, mendoj, do të jetë një produkt i vërtetë artistik.

Motoja jote?

- Mundohu të jesh vetvetja në skenë dhe në ditën e përditshme, sepse kjo të bën më origjinal sesa të imitosh diçka që s'na takon neve.

D. H.

Mihrije Braha- Merilin Monro shqiptare

Mihrije Braha, kudo ku shfaqet, shkëlqen dhe çelësi i suksesit duket të jetë - të bërit e gjërave me zemër. Energjia e saj është e rrallë dhe pa krahasim.

Mihrija është këngëtarja e qindra këngëve, e shumë albumeve muzikore dhe qindra koncerteve anë e kënd botës.

E njohur për zërin dhe sharmin e veçantë, Mihrija po i reziston kohës edhe më tej. Ajo këndon, por edhe prezanton në "Odeon" bashkë me Naim Abazin.

Mihrija disa herë është krahasuar me ikonën e bukurisë botërore, Merilin Monro.

Madje, në disa fotografi të mëherëshme, duket tamam si ylli i pavdekshëm i kinematografisë botërore.

Ç'THOTË KËNGËTARJA PËR KËTË KRAHASIM?

"Merilin Monro mbetet ikonë e bukurisë. As sot nuk e kam vështirë dukjen apo transformimin. I ngjaj asaj", ka thënë Mihrija, duke qeshur.





Pse disa meshkuj nuk dëshirojnë lidhje me femra të famshme?

Meshkujt tregojnë pse nuk dëshirojnë lidhje me femra të famshme, shumë të bukura... E, pse ndodh kjo?

BURIMI, 27 VJEÇ:
U NDAVA NGA E DASHURA VETËM PSE MA SHIKONIN TË TJERËT...

- Kur isha 23 vjeç e pata takuar një vajzë perfekte, të cilën të gjithë e adhuronin. Shoqëria ime mendonte se ishte engjëll. Mirëpo, interesimi i madh i të tjerëve për të më shqetësonte dhe u ndava nga ajo, duke i lënë mundësinë që të jetë me dikë që e meritonte me të vërtetë.

BARDHI, 25 VJEÇ:
KËNGËTAREN E NJOHUR E DOJA, POR NUK NDJEHE-SHA MIRË ME TË!

- Një këngëtare të njohur, me të cilën isha në lidhje tre vjet më parë, e doja. Ishte perfekte, mirëpo nuk ndjehesha mirë me të sa herë që dilja në ndonjë lokal, sepse vazhdimisht e shikonin të tjerët...

VALONI, 32 VJEÇ:
SUPER-VAJZA, ME TË CILËN ISHA NË LIDHJE, AKTRONTE!

- Më tepër më pëlqejnë vajzat e thjeshta, të sinqerta. Qesh njohur me një super-femër, për të cilën të gjithë më thoshin se është shumë e mirë, por e vërteta ishte se ajo kishte shumë aftësi për aktrim.

NDERIMI, 30 VJEÇ:
NUK I ADHUROJ FEMRAT E BUKURA!

- Mendoj se femrat e bukura janë mendjemëdha për të qenë në lidhje me to. Shpeshherë femrat e tilla mendojnë se janë më të mirat në botë dhe kjo është arsyeja pse nuk dëshiroj lidhje me persona të tillë.

LEARTI, 35 VJEÇ:
VAJZA QË E DOJA MUNDOHEJ TË M'I SHTINTE DY KËMBËT NË NJË KËPUCË!

- Para disa vjetësh nuk ndjehesha se jam i gatshëm për lidhje serioze. Nuk ishte problemi te vajzat, por te unë. Dhe, po në atë kohë u njoha me një femër me bukuri të rrallë. Por, shpejt edhe u ndamë, meqë ajo më shikonte "nga ballkoni", se kinse ishte yll për mua.

ÇKA MUND TË PËRFUNDOJMË?

Edhe femrat e bukura duhet ta dinë se partnerin mund ta mbajnë me modesti, sinqeritet, respekt reciprok... Përndryshe, ndodh si me rastin e Leartit, sepse meshkujt nuk dëshirojnë që femrat të jenë dominuese...

Diturie Haxhaj

Mjerë ai që i ka dy dashnore!

Njëri i kishte dy dashnore. I mbante fshehurazi, por në fund e madhja e gjeti me tjetrën. Kur e pyeti pse e tradhtonte dhe nëse e donte më shumë atë, ai iu përgjigj:

- Të kam thënë që jam ashik, prandaj ashiku nuk mund të thotë cilën e do më shumë, por unë u dua të dyjave njësoj. Reagoi e dyta dhe i tha:
- Demek, mua nuk po më do më shumë se tjetrën! Por, dije që m'ke thënë se mua më do më shumë!
- Jo, gabim e ke, u kam thënë se u dua njëjtë.

CILËN NA DO MË SHUMË?

Dhe, përditë e më shumë ashiku hynte në bela me të dyja dhe ato një ditë u grindën aq shumë sa të dyja shkuan te ashiku për ta kuptuar të vërtetën. E madhja i tha ashikut:
- Tash që jemi këtu të dyja, tregona

saktë cilën na do më shumë?

Ai tha:

- U kam thënë se njëjtë u dua...

- Nuk po besoj! - i tha ajo.

Shkoi ashiku në çarshi dhe, duke hyrë në treg, po fishkëllente nga zori i të dashurave. Një tregtar i tha:

"Çka po fishkëllen he burrë, nuk je në mal?!".

Ai iu përgjigj:

"Sikur të ishte ti në vendin tim do të fishkëlleje tri herë më shumë se unë!".

"Pse?".

Dhe, kur ia tregoi dertin, ai ia gjeti ilačin:

"Lehtë e paske he burrë! Bliji dy gjerdanë të kaltër dhe secilës jepja fshehtë nga tjetra. E, kur të pyesin cilën e do më shumë, thuaj asaj që ia kam dhënë gjerdanin e kaltër".

Ashtu edhe veproi: secilës ia dha nga një gjerdan të kaltër tinëz tjetrës.

TI, E MADHJA,

DI PAK NOT,

KURSE E VOGLA JO!

Kur një ditë u takuan të dashurat, u kapën sërish për dashurinë e ashikut dhe erdhën te ai për t'u sqaruar.

"Cilën na do më shumë?", e pyetën ashikun.

Ai u përgjigj:

"Asaj që ia kam dhënë gjerdanin e kaltër!".

Duke parë e madhja se aty kishte një hile, pasi kuptoi se ishte bërë një mjeshtri, i tha:

"Lëre ti gjerdanin e kaltër, por më thuaj mua nëse ne të dyja biem në ujë, cilën do e shpëtoje më parë?".

Ashiku i tha:

"Më duket se ti di nga pak not e kjo e vogla nuk di fare!".

R.

Si ia gjeta ilaçin gruas sime?

Para 50 vjetësh njerëzit shëndetin e shikonin nëpërmjet peshës dhe mbipeshës. Cila ishte tula e dhjamë kur ishte vajzë, e kërkonin për nuse nga të gjitha anët. Kur njerëzit shihnin në rrugë një vajzë, që tash themi “trashalluçe”, përmendej për të mirë në shtatë katunde...

Një nënë që jetonte në Prishtinë, pothuajse, çdo ditë kishte mysafirë nga fshatra të ndryshëm. Sa herë ata të fshatit kishin nevojë të shkonin te mjeku, në mbrëmje vinin mysafirë te ajo për ta kaluar natën, në mënyrë që te mjeku ta zënin rendin në mëngjes. Sepse, në atë kohë kishte pak mjekë e shumë pacientë... Dhe, pas kontrollit te mjeku, ata ktheheshin edhe një herë te ajo që t'i merrnin gjësendet që i kishin me veti, por edhe të përsëndeteshin. Ajo ishte kureshtarë e madhe të dinte se çka u ka thënë mjeku dhe ç'barna u ka dhënë. Dhe, pasi i shikonte mirë barnat nga pamja e jashtme e ambalazhit, u thoshte: "Barna të mira të paska dhënë!".

RASTI I SALËS...

Në fëmijërinë time Salën e kam pasur kojshi. Ajo i qonte fëmijët te mjeku kryesisht dimrit, kur edhe ftoheshin. Barërat që mjeku ua jepte fëmijëve, së pari, i merrte vetë që t'ua dinte shijen, e tek atëherë ua jepte fëmijëve. E, nëse nuk kishin shije të mirë nuk ua jepte fare...

BURRI QË E QONTE GRUAN ME VITE TE MJEKU...

Një burrë i fshatit tim e qonte gruan te mjeku me vite të tëra, sepse i dhembte koka. Mjeki i jepte ilaçe, por nuk i ndihmonin. Pas një kohe mjeku ndodhej në të njëjtin autobus me burrin e saj. Pasi e njohu, mjeku i tha: "A t'i kaloi gruas dhembja e kokës?". "Jo", i tha ai. Dhe, muhabet pas muhabeti mjeku ia përmend edhe temën e ushkurit. "A po bënë punë natën me gruan?". "Po", i thotë shkurt ai, sepse nuk dëshironte të fliste për këtë temë. "More, a po e përjeton gruaja qat të mirën e fundit?", i thotë mjeku. "Nuk e di! A edhe ajo duhet me përjetua, a?!". "Këtu edhe është halli... Mu për atë edhe i dhemb koka vazhdimisht!", ia kthen mjeku. Dhe, që nga ajo mbrëmje ai me gruan e kryen detyrën e vet ashtu si duhet dhe pa u ngutur fare... E, një herë tjetër, kur takohet me mjekun, i thotë: "Doktor, tash ja ke gjetur gruas sime ilaçin. Kurrë më nuk po i dhemb koka!".

S. M.



Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
Shkabaj për Android

ANDROID APP ON
Google play

Shkabaj
www.shkabaj.net

JARDIN



Iu ktheva burrit se nuk pata qare, jo se e dua!

Jam 30-vjeçare, nënë e dy vajzave. Para pesë vjetësh isha në proces për ndarje nga burri, shkaku se dallimi i madh që kishim në moshë, bëri që ftohen ndjenjat ndaj njërit-tjetrit.

Ajo që në martesën tonë shkaktoi plasaritje të madhe ishte ndryshimi që kemi në moshë unë me tim burrë, e që në fillim të martesës sonë nuk na pengonte fare... E, e keqja më e madhe ishte se unë e braktisa familjen në moshë shumë të re, në mënyrë që të jem me të... Por, nuk zgjati shumë dhe gjërat në martesën tonë erdhën duke u ftohur dhe arritën deri në divorc, pasi ai nënshkroi një dokument që shtëpia ku jetonim ne ua falë familjes. Dhe, këtë e bëri pa u konsultuar fare me mua, thuaja se unë nuk isha grua e tij dhe fëmijët nuk ishin të tij...

SI U NJOHA ME TJETRIN DERISA PRISJA DIVORCIN NGA BURRI?

Procedura për divorc zgjati gjashtë muaj. Por, gjatë kësaj kohe u njoha me një person, i cili edhe e ndërroi kahun e jetës sime. Sidoqoftë, në fillim nuk e doja edhe aq shumë, por me kalimin e kohës u dashurova tmerrësisht në të... Por, e keqja në këtë lidhje të re ishte se ai është 6 vjet më i ri se unë, e frikësohem se me kohë do i bëhem bajate, shkaku i moshës që kam. Megjithatë, e keqja edhe më e madhe ishte se unë tashmë jetoja në

shtëpinë e familjes sime dhe vëllai në atë kohë do martohej. Nusja e tij i kishte dhënë kusht që unë të mos jem në atë shtëpi ku do të vinte ajo, sepse, sipas saj, e pengonin vajzat e mia, të cilat i kam me vete.

SI MË KËRKOI BURRI FALJE?

Dhe, erdhi një moment shumë i vështirë për mua: kah t'ia mbaja... Ndërkohë, mu në ato përplasje, burri që tashmë nuk jetoja me të, erdhi dhe kërkoi t'i kthehesha, duke më kërkuar falje për gjithçka që ka ndodhur...

Dhe, pasi bisedova shtruar me vëllanë për problemin tim, më propozoi që t'i kthehesha burrit, kryesisht shkaku i vajzave që të mos jetonin pa baba. E, kur vendosa t'i kthehem, burrit i thashë s'po kthehem për ty, por për hatër të vajzave jam në gjendje të bëj gjithçka...

Por, edhe pse iu ktheva burrit, zemra më ka mbetur te dashnori, sepse atij i jam dorëzuar me mish e me shpirt.

Sidoqoftë, e keqja më e madhe është se, edhe pse iu kam kthyer burrit, kurrë më nuk fle me të, por me vajzat e mia... Kjo bëri që burri ta kuptoj se më nuk e dua... se jam kthyer vetëm për hir të vajzave, se zemra ime tashmë i përket dikujt tjetër e jo atij...

E. E, Ferizaj



*Qendra
më e madhe
e dobësimit
në Kosovë*



* Të lodhur nga mbipesha? Ndryshimin e shpejtë e gjeni te ne!

* Mbipesha është një gjendje nga e cila shkaktohen një numër i madh i sëmundjeve, si: sëmundje të zemrës dhe infarkti, rritje të presionit arterial, diabeti, dhimbje shpine, gurët në tëmth, osteoartriti, probleme me frymëmarrje, konkretisht astma dhe apneni, disa kancerw, depresion etj.

* Qendra e Dobësimit "Shkenda Dubova" që disa vjet ndihmon në trajtimin dhe humbjen e peshës, duke ofruar programe të përshtatura për individët, të cilët janë duke luftuar mbipeshën dhe kilet e tepërta. Përmes aparaturave tona ju do të eliminoni dhjamin në mënyrë natyrale, si lloj gjimnastike pasive, duke kaluar nëpër 5 lloje të aparaturave. Humbja në peshë nëpërmjet aparaturave vjen si pasojë e djegieve të kalorive.

* Te ne humbja e kilogramëve nuk është e vështirë dhe shumë shpejt do e ndërroni pamjen tuaj nga mbipesha në peshë ideale. Qendra jonë përdorë aparaturat më moderne të gjeneratës së fundit të specializuara në këtë fushë. Gjatë një seance realizohen pesë procese: dobësim, modelim, drenim, tonifikim dhe detoksikim. Një seancë e plotë dobësimi ka kohëzgjatje 2,5 orë.

* Së pari klienti i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohet: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie klienti humbë 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi dhe reduktim të perimetrit deri në 10 cm për vetëm 10 seanca. Le të shikojmë në detaje karakteristikat e aparaturave:

* Perfect body-tunnel sauna. Kjo është një aparaturë e fundit dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i të cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore, teknike dhe pa efekte anësore, kuruese për shumë sëmundje. Aktivizon molekulat e ujit, duke përmirësuar thithjen e oksigjenit, përmirëson qarkullimin e gjakut, nxit metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epiderme) dhe shpërbën grumbullimin e yndyrës të lokalizuara në bark, vithe dhe kofshë. Në mjekësi IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve, si: sëmundjet reumatike; sëmundjet degjenerative të nyjave; gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët); inflamacionet e hapësirave paranazale etj.

* Body shape(seaming) - kabina me avull. Është një teknologji e projektuar si terapi estetike që kombinon efektin termik të nxehtësisë me efektet e dobishme të avullit dhe aromaterapisë. Funksionet dhe benefitet kryesore: - temperatura e lartë brenda në kapsulë do të hapë poret e lëkurës dhe ndihmon në pastrimin e thellë të lëkurës, e si pasojë do të përmirësohet qarkullimi limfatik, detoksikohet trupi dhe efekt lipolitik apo reduktimi i shtresave dhjamore në trup. - Eliminon shumë qeliza të vdekura dhe kryen ajrosjen e lëkurës përmes djersës, rrit elasticitetin e lëkurës, stimulon prodhimin e kolagenit të ri dhe ngadalëson rrudhosjen e lëkurës. - Çlodhje muskulore dhe efekt relaksues, përmirësim të disponimit. - Efekte stimuluese në sistemin imunitar dhe në mbrojtjen antivirale. - Efekt analgjezik, lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike.

* Body shape - kabina e shtrirë. Një tjetër pajisje që sjell shumë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet: - Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore. - Eliminon kilogramët e tepërt dhe rimodelon formën trupore. - Lehtësimin e dhimbjeve nga patologji të ndryshme, si dhimbja e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin. - Rrit qarkullimin e gjakut, duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit tonë me elemente ushqyese. - Tonifikim i thellë. - Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ul stresin. - Përmirëson sistemin nervor. - Zhduk në mënyrë të ndjeshme celulitin, duke eliminuar shtresat dhjamore. - Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës. - Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve. - Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit. - Lehtëson gjendjen e depresionit.

* Sauna tradicionale nga druri i pishës. Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi: - detoksifikim; përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ul tensionin arterial; humbje të peshës; eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate; relaksim muskolor.

* Elektrostimulatorët muskolorë. Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm përderisa jeni duke shkruirë dhjamin, përmes elektrostimulimit tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qullet trupi, stimulohet muskujt dhe ngushtohet perimetri. Vërejtje: Personat me probleme kardiovaskulare (të zemrës, venave), diabetit, shtatzënat dhe ata me epilepsi nuk u lejohet përdorimi i aparaturave tona.

PRISHTINË: 045/224-540
(Dragodan tek komuna e re)

GJILAN: 045/505-043
(Mbrapa postës së madhe)

GJAKOVË: 044/545-444
(Në tranzit rr.Tirana)



NË NATËN E PARË TË MARTESËS GRUAJA NUK PRANON TË ZHVISHET!

Kohë më parë, një burrë në Tainan bëri kërkesë për divorc, i cili pretendonte se e shoqja ishte aq e turpshme, saqë nuk pranonte të kryente marrëdhënie seksuale edhe pas një viti martesë.

Çen, mësues 38-vjeçar, nga Tainani, ishte martuar me 29-vjeçaren Lin, gjithashtu mësuese. Sipas Çenit, në natën e parë të martesës ajo fjeti e veshur me fustan dhe e mbështjellë me jorgan.

BURRI PËRPIQET T'IA SHOHË FYTYRËN GRUAS PAS 30 VJETËSH MARTESË

Në Arabinë Saudite, në vitin 2008, një grua kërkoj divorc, sepse burri i saj u përpoq t'ia shihte fytyrën pas 30 vjetësh martesë. Ai kishte jetuar me të shoqen për 30 vjet me radhë, pa i hedhur sytë në fytyrën e saj.

Gruaja 50-vjeçare ndiqte traditën e fshatit të saj të lindjes në afërsi të Khamis Mushajt, duke mbajtur fytyrën të mbuluar gjatë gjithë kohës. Një natë i shoqi ishte bërë kurioz dhe kishte provuar t'i hiqte burkën, ndërsa ajo flinte, në mënyrë që t'ia shihte fytyrën, por ajo ishte zgjuar dhe nuk ishte pranuar.

NUSES NUK I HAHEJ DREKA ME VJEHRRËN!

Më 2005 një grua rumune kërkoj divorc, sepse nuk mund të duronte faktin e të ngrënit drekë çdo ditë me vjehrrën. Gruaja 22-vjeçare kishte vetëm 10 muaj e martuar kur u ankua se jeta e saj ishte kthyer në një makth shkaku i vjehrrës. Elena T., nga Focsani, në provincën Vrancea, i tha gjykatësit se prania e vjehrrës së saj në vaktin më të rëndësishëm të ditës, po ia shkatërronte jetën dhe kërkoj sa më parë të divorcohej nga burri i saj.



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE

Në vend të gruas sime, në shtrat më erdhi shtriga!

As sot nuk e kam të qartë se ç'ndodhi me mua natën e parë të martesës. Atë që e kisha dashur aq shumë, pesë vjet rresht, në natën e parë të martesës më ngjante në shtrigë dhe kjo bëri që ta përdorja dhunën ndaj saj, ndonëse tash vuaj për të, sepse e dua shumë.

E kam humbur dashurinë time përgjithmonë po atë natë kur u martova me atë që e kisha dashur më shumë se vetveten. Diçka e çuditshme ka ndodhur në jetën time atë të diel martese kur isha jashtë vetes sime. As tash nuk di se çka ndodhi atë natë me mua, por mund ta përshkruaj sjelljen time të keqe dhe veprimet e mia të pamatura.

Kishim pesë vjet që ishim bashkë. E caktuam edhe ditën e martesës, e që, edhe pse nuk ishte larg, neve na dukej e largët.

NË MOMENTIN KUR HYRA DHËNDËR, GRUAJA QË E DOJA ISHTE TJETËR!

E di se kur ka filluar dasma kam qenë në gjendje normale deri në momentin kur kam hyrë dhëndër. Ma kanë uruar të gjithë martesën dhe e di se kam hyrë në dhomën time, ku më priste nusja. Kur kam hyrë brenda më janë ngritur flokët përpjetë. Jam ulur në shtrat dhe jam munduar ta qetësoj veten. Filloi

t'më dhembte koka dhe më bëhej se gjaku më dilte prej veshëve. Nusja më është afruar, por kur e kam shikuar mirë në fytyrë nuk më ngjante në atë që e kisha dashur pesë vjet rresht.

"Oh, Zot, a është kjo ajo të cilën pesë vjet e kam dashur dhe për të cilën kam vuajtur shumë?", i thash vetes. Ajo, si duket, e kuptoi se me mua diçka nuk ishte në rregull dhe më pyeti se a ndihesha mirë.

"Kush je ti?", i thash pa dashje.

"Nuk është sonte nata të tallemi!", ma ktheu me buzëqeshje.

"Ti nuk je e dashura ime. Ti më shumë i ngjanë një shtrigë!", më dolën pa dashje këto fjalë nga goja.

Pas një kohe shqetësimi im sa vinte e shtoej, aq sa nusen fillova edhe ta grushtoj. Me tërë fuqinë time i rashë shuplakë, kurse ajo nuk më kundërshtoi fare.

"Çka po ndodhë me ty?!", më tha pas shuplakës së parë që ia dhashë.

Kjo më pengoi edhe më shumë dhe jam ngritur sërish në këmbë për ta grushtuar së dyti.

SI MË NXORËN SHKELMA NGA DHOMA VËLLEZËRIT E MI?

Në çast ajo ka bërëtitur dhe fill pas pak brenda janë futur vëllezërit e mi, të cilët, kur më kanë parë në atë gjendje, më kanë shtrënguar fort për trupi dhe më kanë nxjerrë jashtë, duke më qortuar me fjalët më të rënda të mundshme.

"Ma largoni nga shtëpia ose do ta vrasë!", u thash teksa mundohesha ta qetësoja veten.

Pas një kohe e di se më ka zërë gjumi dhe kur jam zgjuar nusen nuk e kam gjetur në shtëpi, sepse natën ajo veç kishte ikur. Të nesërmen isha po ai njeri që kam qenë gjithnjë dhe mendja më rrinte te e dashura ime...

As sot e atë ditë nuk e di se çka ndodhi me mua, por di se, edhe pse kanë kaluar dy vjet, unë ende e dua dhe vuaj shumë për të, ani pse më kurrë s'e kam parë.

V.T.



Adresa: Rr. Eduard Mano, Kopshti Zoologjik 1001 Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 69 258 8889 ; **Web:** www.unikhotel.al; **Email:** info@unikhotel.al

Vetullat, sytë, hunda e goja tregojnë çfarë je në seks!

Vijat e fytyrës sonë flasin çdo gjë mbi aftësitë tona, por edhe për dëshirat në shtrat...

VETULLAT

Të vogla dhe të rralla: pa interesim fare për seks, mirëpo interesim të madh për shpirt-mirësi.

Të dendura dhe të trasha: person shumë seksual dhe i hapur për eksperimente të reja, mbase edhe për tradhti.

SYTË

Sytë të shkëlqyeshëm: gjithmonë në kërkim të sfidave të reja, lehtë kënaqen seksual-

isht, ndërkah dashurisë nuk i përkushtohen shumë, andaj edhe nuk janë besnikë.

Sytë të errët: person i zjarrtë, i cili kënaqet në seks të gjatë dhe të paramenduar, dinamik në krevat, e adhuron seksin, mirëpo vështirë hapet.

GROPAT E SYVE

Gropat e syve të vogla dhe të holla: janë persona me apetit të madh seksual, gjithmonë të gatshëm dhe të hapur për çdo gjë.

Gropa të syve të trasha dhe të mëdha: mendojnë shumë mbi seksin, kanë libido shumë të fuqishme dhe dëshirojnë çdo gjë që ka të bëjë me seksin.

HUNDA

Hunda petuc: janë persona që dëshirojnë seks romantik dhe poza tradicionale, nuk u interesojnë eksperimentimet dhe mund të jenë nga pak monoton.

Hundë e rrafshët apo pak hundë gungaç: adhurojnë seksin, e duan në sasi të mëdha dhe janë të shkëlqyeshëm në shtrat.

GOJA

Goja e madhe: dashnorë të sinqertë, të cilët dëshirojnë të kënaqin personin tjetër, janë shumë potentë. Nëse është fjala për gojë të plotë, atëherë sensualiteti është i sigurt.

Goja e vogël: janë dashnorë fantastikë dhe inventivë, mirëpo shpejt arrijnë orgazmën. Janë të sinqertë dhe besnikë.

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për stresse, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Magjistare, më ndaj nga burri!

E nderuara Magjistare, je e vetmja shpresë imja, te ti mbështesë besimin e fundit. Jam grua, 31 vjeçe, por më duket se jam gruaja më e vjetër në botë. Jam e martuar qe 7 vjet. E desha shumë burrin, ia pagova borxhet, ia rregullova letrat dhe nisën problemet... Ai filloi të mos vij me rregull në shtëpi. Unë u dashurova në një burrë tjetër.

U ndamë me burrë... U bashkuam... Kështu, disa herë... Dua të më ndash përgjithmonë prej burrit! Të lutem, më ndihmo!

"Gjallë e pak pa dekë"

Përgjigje:

Syri im moti nuk ka parë problem më të rëndë, e nderuara zonjë! Por, më duhet të t'i them disa gjëra të vërteta, pa politikë. Fajin e ke ti. Së pari, në jetën tënde bashkëshortore e ke futur personin e tretë, me të cilin e ke edhe djalin dhe me këtë e ke denigruar burrin, i cili e di fort mirë se djali nuk është i tij.

Të gjitha fjalët për borxhet e paguara i ke përmendur për të arsyetuar fajësinë tënde. E, sa i përket së ardhmes, të garantoj se nuk ke perspektivë me

burrin që je, e as me të dashurin, i cili të ka vetëm për kënaqësi.

Më ka lënë shtatzënë dhe iku!

Jam një vajzë, 26 vjeçe, e kam një hall të madh. Kam kaluar katër vjet me një djalë, me të cilin kam ndarë të mirën e të keqen dhe, kur mendoja se ai po më bën zgjidhje, iku jashtë vendit dhe më la shtatzënë në muajin e pestë. Kam shkuar në disa ordinanca, por askush nuk po guxon të bëjë abortin tim. Sa isha me të i thashë se duhet të abortoj për të mos i bllokuar rrugët e mia të jetës, por ai më thoshte se ne do të martohemi dhe nuk donte të abortoja, ndërkohë iku jashtë vendit. Nuk di a ka pasur atje ndonjë lidhje apo ma bëri këtë gjë për inati... Tani jam para çmendurisë...

"Vdekja troket"

Përgjigje:

Nuk je fajtores për gjendjen që e ke sot. Familja e di se keni qenë bashkë dhe gabimi yt është që po e mban fshehurazi nënës problemin që ke. Mirë është të komunikosh me nënën dhe të kërkossh ndihmën e saj, por edhe ndihmën e familjes së personit që të ka braktisur. Kjo gjë duhet të bëhet

shpejt dhe pa humbur kohë, në mënyrë që të bësh zgjidhjen e domosdoshme.

Populli thotë: "Nuk ka shtëpi pa derë". Prandaj, edhe problemi yt ka zgjidhje

Çka po kërkon profesori?

Përsëndetje zonja magjistare, jam vajzë, 18 vjeçe, nxënëse në gjimnaz. Më është paraqitur një profesor imi. Më ka shprehur dashuri...

"Prz"

Përgjigje:

Është jashtë etikës së tij profesionale të kërkoj dashuri nga nxënësjë. Është gjë e keqe që ai, si profesor që të jep mësim, njëkohësisht, të shprehë edhe dashuri, sepse profesioni prej pedagogu nuk i jep të drejtë.

Pse kam probleme me cikël mujor?

Jam një vajzë, 27-vjeçare, e punësuar dhe nuk e kam gjetur ende fatin e jetës. Kam probleme me cikël mujor, shpesh më vonohet, por ka raste që më vjen edhe para kohe. Kam edhe dhimbje gjatë asaj kohe. Po frikësohem se mund të kem diçka të keqe në mitër...

"Pa shifër"

Përgjigje:

Cikli mujor nuk duhet të shoqërohet me dhimbje të padurueshme. Me këto probleme që i keni duhet të kontrolloheni te gjinekologu, i cili edhe do ua caktojë diagnozën dhe në bazë të saj edhe terapinë shëruese. Nuk është turp të kontrolloheni te gjinekologu, edhe pse ende jeni vajzë. Në anën tjetër, ka edhe femra gjinekologe dhe do ta keni më lehtë të përcaktoheni për kontroll.



SHERWOOD

Resorts and Hotels

Feel the Legend

**SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
DREAMS RESORT**
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE
BELEK**
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD
SUITES RESORT**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
GREENWOOD RESORT**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
PRIZE HOTEL**
LARA / ANTALYA

+90 242 444 88 07
www.sherwoodhotels.com.tr

